

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZYRTARIZON BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL ME KËSHILLIN GJYQËSOR TË PORTUGALISË

Faqe 2-5

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Portugalisë nënshkruan një memorandum mirëkuptimi, në kuadër të vizitës së punës që Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi në Lisbonë.



### ILD në shifra

83 vendime nga 142 praktika të trajtuara:  
54 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar  
29 vendime arkivimi pas verifikimit

29 vendime verifikimi

1 vendim për fillim hetimi disiplinor  
për 1 magjistrat (prokuror)

### Qytetari në Zyrën e ILD-së

#### Gjatë muajit Mars 2026:

- Janë pritur **28 ankes**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Janë realizuar **24 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës;
- Janë trajtuar **28 kërkesa** për informacion.



Edukimi ligjor nis nga shkolla:  
Metani takime në Përmet e  
Këlcyrë  
Fq. 6-8



Maturantë të Gjimnazit “Petro  
Nini Luarasi”, vizitë studimore  
në ILD  
Fq. 9-11

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZYRTARIZON BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL ME KËSHILLIN GJYQËSOR TË PORTUGALISË



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Portugalisë nënshkruan një memorandum mirëkuptimi, në kuadër të vizitës së punës që Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi në Lisbonë.

Memorandumi i nënshkruar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Gjyqësor të Portugalisë, z. Luís Azevedo Mendes synon krijimin e një kuadri bashkëpunimi reciprok dhe të qëndrueshëm në fushat e inspektimeve gjyqësore, hetimeve disiplinore dhe çështjeve me interes të ndërsjellë, me qëllim forcimin e integritetit dhe etikës profesionale, zhvillimin institucional dhe përmirësimin e kapaciteteve të palëve. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor i Portugalisë u dakordësuan të bashkëpunojnë përmes shkëmbimit të informacionit dhe dokumentacionit, vizitave studimore dhe shkëmbimeve të stafit, organizimit të aktiviteteve trajnuese dhe takimeve tematike, zhvillimit të projekteve dhe nismave të përbashkëta, si dhe forma të tjera bashkëpunimi të dakordësuara.

Gjatë takimit zyrtar në Këshillin Gjyqësor të Portugalisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, së bashku me delegacionin shoqëruar, u njohën me kompetencat e Këshillit dhe me funksionimin e shërbimit të inspektimit të gjyqtarëve. Nga ana e tij z. Metani paraqiti funksionet e ILD-së, si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Gjatë vizitës në Gjykatën e Lartë, delegacioni nga ILD, u informua mbi procesin e inspektimit të gjyqtarëve të gjykatave të larta dhe u shkëmbyen përvoja mbi praktikën e mbikëqyrjes.

Vizita në Gjykatën e Apelit të Portos përfshiu sesione pune dhe diskutime mbi monitorimin dhe vlerësimin e performancës së gjykatave dhe gjyqtarëve, regjimin disiplinor, sanksionet dhe procedurat disiplinore në të gjitha fazat e tyre. Gjithashtu, u prezantua projekti MEENOS, i cili synon thjeshtimin e gjuhës së përdorur në vendimet gjyqësore për të rritur qartësinë dhe aksesueshmërinë e tyre. Projekti MEENOS (Modernizimi i Efikasitetit dhe Ndërveprimit në Sistemin Gjyqësor) është një iniciativë e Këshillit Gjyqësor të Portugalisë, që synon përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe qartësisë në funksionimin e sistemit gjyqësor, përmes praktikave inovative, trajnimeve dhe standardeve të avancuara të komunikimit profesional, përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe qartësisë në funksionimin e sistemit gjyqësor, përmes praktikave inovative, trajnimeve dhe standardeve të avancuara të komunikimit profesional.

Bashkëpunimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Portugalisë zhvillohet prej kohësh, edhe në kuadër të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), ku të dy institucionet janë anëtare, me fokus në shkëmbimin e praktikave dhe forcimin e standardeve të inspektimit në drejtësi.

*Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Portugalisë*

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR





## EDUKIMI LIGJOR NIS NGA SHKOLLA: METANI TAKIME NË PËRMET E KËLCYRË



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, i shoqëruar nga inspektorë dhe anëtarë të stafit të ILD-së, zhvilloi takime pune me nxënës dhe mësues të shkollave “Nonda Bulka” në Përmet dhe “Kamber Bënja” në Këlcyrë, në kuadër të strategjisë së komunikimit publik të institucionit për promovimin e edukimit ligjor. Këto takime synojnë forcimin e ndërveprimit të ILD-së me komunitetin, përmes kontakteve të drejtpërdrejta me grupe të ndryshme shoqërore në të gjithë vendin.

Në shkollën “Nonda Bulka” në Përmet, nxënësit kishin përgatitur dhe paraqitën kuzhin “Dilema të drejtësisë”, duke u përfshirë në një debat të strukturuar, të ndarë në dy skuadra, me argumente pro dhe kundër mbi rastin e trajtuar. Angazhimi dhe niveli i diskutimit u vlerësuan me shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit.

Gjatë komunikimit me nxënësit, si edhe me trupën arsimore të të dyja shkollave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, theksoi rëndësinë e edukimit ligjor të brezit të ri,

si një mënyrë për formimin e qytetarëve të informuar dhe për rritjen e besimit të publikut te drejtësia.

Duke folur për traditën që ka krijuar ILD përmes bashkëpunimit me studentë dhe nxënës shkollash, z. Metani tha se ndërveprime të tilla me institucione të drejtësisë duhet të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vuri në dukje se shkollat janë vendi kur formohet shoqëria, që nesër do të jenë pjesë, edhe e fushës së drejtësisë.

Drejtorët e shkollave znj. Anida Hajredini e “Nonda Bulka” në Përmet dhe z. Arben Zoto e “Kamber Bënja”, në Këlcyrë falenderuan Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për përzgjedhjen e këtyre shkollave për këtë takim informues dhe e njohën z. Metani dhe ekipin e tij me ecurinë e aktivitetit arsimor dhe traditën institucionale, e pasqyruar tek muzeu i shkollës.





## MATURANTË TË GJIMNAZIT “PETRO NINI LUARASI”, VIZITË STUDIMORE NË ILD



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mikpriti sot një grup maturantësh të gjimnazit “Petro Nini Luarasi” të Tiranës, për një vizitë studimore në ILD, një praktikë e konsoliduar e institucionit në kuadër të informimit përmes edukimit ligjor të të rinjve, jo vetëm me institucionet arsimore në Tiranë, por edhe në rrethe. Në nisje të aktivitetit, të rinjtë u përshëndetën nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, i cili mes të tjerash vërejtë se është e rëndësishme që ILD të jetë sa më afër shkollave, ndërsa u shpjegoi të rinjve konceptin e ndarjes së pushteteve, pavarësinë e tyre dhe rolin e ILD-së mes tre pushteteve, ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit. Z. Metani tha se Kushtetuta e ka parashikuar ILD-në si një mekanizëm për të kontrolluar dhe mbikëqyrur punën e gjyqësorit, sa i takon shkeljeve apo abuzimeve, por pa cenuar pavarësinë e tyre në vendimmarrje.

Më tej ishte inspektorja jomagjistrate znj. Joana Sorraj dhe ndihmës inspektori z. Julis Zebi, që i njohën maturantët me mënyrën si funksionon Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe si mund të përdoret nga qytetarët. Ata u shpjeguan maturantëve rolin dhe funksionet e ILD-së, mënyrat sesi zhvillohet në praktikë puna e institucionit dhe sfidat për ta bërë sistemin e drejtësisë më efikas dhe më të besueshëm për publikun.

Gjithashtu maturantët mësuan se si bëhet një ankesë në ILD, kush ka të drejtë të paraqesë një ankesë dhe nëse vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të nisë një procedurë disiplinore edhe pa ankesë, pra me iniciativën e tij.

Inspektorja Joana Sorraj dhe ndihmës inspektori Julis Zebi, iu përgjigjën interesit të gjimnazistëve, që aspirojnë vijimin e studimeve për drejtësi, mbi proceset e punës së inspektorëve, afatet e shqyrtimit të ankesave, pranueshmërinë e një anese dhe pozicionin e magjistratit, gjatë një hetimi e procedimi disiplinor. Inspektorja Joana Sorraj e vuri theksin tek rëndësia që institucioni i jep respektimit të pavarësisë së magjistratëve, balancës me llogaridhënien e tyre, si dhe interesit legjitim të qytetarëve për mënyrën sesi administrohet drejtësia. Një tjetër temë që u diskutua ishte roli monitorues i ILD-së në sistemin e drejtësisë, përmes inspektimeve në gjykata dhe prokurori, si dhe rezultatet që dalin nga këto inspekte. Kjo vizitë studimore është pjesë e aktiviteteve që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë organizon brenda dhe jashtë institucionit me grupe të ndryshme shoqërore, në kuadër të programit 2026–2028 për informimin, edukimin ligjor dhe ndërgjegjësimin e publikut, me qëllim marrjen e njohurive ligjore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e zbatimit të ligjit.





## MARSI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit Mars 2026 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 136 **ankesa**, nga ta cilat **208 ankesa të depozituara nga qytetarë**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit Mars 2026.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p><b>83 vendime nga 142 praktika të trajtuara:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>· 54 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar</li><li>· 29 vendime arkivimi pas verifikimit</li></ul>	<p><b>29 vendime verifikimi</b></p>	<p><b>1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat (prokuror)</b></p>

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.



### *Gjatë asistimit të ankuesve*

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217. Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Mars 2026, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **9 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikua prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijën ankuesit.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit [elis.kuci@ild.al](mailto:elis.kuci@ild.al)

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Mars 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **28 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD

- 8942 të konfirmuara
- 6693 të trajtuara
- 2249 në proces trajtimi
- 148 në proces verifikimi
- 146 magjistratë të hetuar
- 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)



Thematic and Institutional Inspections

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm në inspektime dhe hetime disiplinore, ndërtojmë integritet, etikë profesionale dhe institucione më të forta. #ILD #KëshilliiLartëGjyqësor



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZYRTARIZON BASHKËPUNIMIN...

From ild.al

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Sot në takimin e 17-të të Nënkomitetit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë. Paraqita ecurinë e punës së #ILD-së dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i antarësimit. #ILD #EU



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Vazhdon tradita jonë e bashkëpunimit me nxënës e studentë për ta bërë #edukimiligjor mbi #ILD dhe sistemin e drejtësisë në Shqipëri të kuptueshëm dhe të aksesueshëm. #ILD #edukimiligjor #Përmet #Këlcyrë



EDUKIMILIGJOR NIS NGA SHKOLLËN 'METANI' TAKIME NË PËRMET E...

From ild.al

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Kehaqesi bashkëbisedimi mëngjesin e sotëm me nxënësit dhe mësuesit e shkollës 'Kamber Bënja' në #Këlcyrë me interes për drejtësinë dhe parimet e shtetit ligjor. #ILD #komunikimpublik #edukimiligjor



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD

- 8867 të konfirmuara
- 6642 të trajtuara
- 2188 në proces trajtimi
- 144 në proces verifikimi
- 145 magjistratë të hetuar
- 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD

- 8991 të konfirmuara
- 6720 të trajtuara
- 2271 në proces trajtimi
- 146 në proces verifikimi
- 147 magjistratë të hetuar
- 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...**  
@ILD\_Albania

Debatues të shkëlqyer nxënësit e #shkollës "Nonda Bulka" të Përmetit në trajtimin e kazusit ligjor që paraqitën sot. Komplimente edhe drejtuesve e mësuesve për angazhimin në edukimi ligjor dhe qytetar i brezit të ri. #ILD #edukimiligjor #nxënës #Përmet



MARS 2026


Të gjitha të drejtat e rezervuara  
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

## KONTAKT

WEB: [ild.al](http://ild.al)  
TEL: +35542217217  
EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!